1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

**DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>1</sup>**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond \_\_\_\_\_

limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

## **Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kritereve te pergjithshme per kualifikim .

### **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit 2017, 2018 dhe 2019,



duhet te mos jete me e vogel se 50% e fondit limit te procedurës se prokurimit. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve te fundit 2016, 2017 dhe 2018. ose nëse operatori e ka dorëzuar bilancin e vitit buxhetor 2019, mund të paraqesi kopje të bilanceve për tri vitet 2017, 2018, 2019 .*Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit ( si me sipër), të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet , **ne te cilat duhet te rezultoje se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem.** si dhe te shoqeruara me akt ekspertizen e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.*

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet 2018

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.**

## **2.3 Per kapacitetin teknik:**

**2.3.1/a** Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

**2.3.1/b.** ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, **është jo më e vogel se dyfishi i fondit limit** dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese **formulet e vleresimit** sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar **me kontraten/kontratat** e nenshkruara nga palet, **situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit.** Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.*

*2.3.1.b Në rastin e perves se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi **formulet e vleresimit** sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar **me kontrate** e nenshkruara nga palet,**Leje ndertimi, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi te objektit,***

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e*

**“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”**

*bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punesim mesatar, me jo më pak se 200 punonjes, për periudhën (Shtator 2019 – Shkurt 2020), e vërtetuar kjo me: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

2.3.3 Operatori Ekonomik për kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt, duhet të ketë në Stafit teknik kryesor të inxhinierëve minimalisht,

- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi;*
- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi/profili transport;*
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik*
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik*
- 3( tre) Inxhinier Topograf*
- 2 (dy) Inxhinier Elektrik*
- 2 (dy)Inxhinier Gjeolog*
- 2dy) Inxhinier mjedisi*

*Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV,*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.

2.3.5 Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP – 7/C (Ujësjetësia, gazsjellësia, vajsjetësia, vepra kullimi e vaditje.)
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese )

**“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”**

- NS – 7/D (Bariera dhe mbrojtje rrugore)
- NS -18/ A (Punime topogjeodezike)

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturs dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.***

2.3.6. Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:

- License për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane qe kane ndikim ne mjedis, Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.
- Licence III.2.A (1+2) - Veprimtarite e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

*Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, sejcili prej Operatoreve do paraqese licencen e mesiperme.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e e rregullores ”Për sigurine në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, si dhe duhet të jetë i përfshirë në listëpagesen e shoqerise per periudhen Shtator 2019 – Shkurt 2020.

*Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, sejcili prej operatoreve duhet të ketë të punesuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”*

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periushen Shtator 2019 – Shkurt 2020, punonjes si me poshte;

- 1 (nje) Inxhinier \_ Çertifikuar si Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis.
- 1 (nje) Inxhinier \_ Çertifikuar per Sigurimin dhe kontrollin e cilesise ISO9001:2015

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 15 (pesembedhjete) punonjes manovratore, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, si dhe te figuroje ne lispagesat e shoqerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 25 (njetete e pese) punonjes shofere, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, patenten perkatese, si

*“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”*

dhe te figuroje ne lispagesat e shoqerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit.

**2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit punonjësit ne përputhje te plote me VKM nr. 632, date 15.07.2015, i ndryshuar.**

Operatori Ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit Nje Mjek ne perputhje te plote me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njesi</b>	<b>Sasi</b>	<b>Statusi</b>
1	Kamiona vetshkarkues min 20 ton	Copë	25	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetshkarkues 10 deri 18 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine deri 4.5 ton	Copë	6	Në pronësi ose me qera
4	Ekskavatorë me zinxhire	Copë	8	Në pronësi ose me qera
5	Ekskavatorë me goma	Copë	6	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome me goma	Copë	3	Në pronësi ose me qera
7	Minieskavatore	Copë	6	Në pronësi ose me qera
8	Çekiç për Eskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Autobot Uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
10	Autobetoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Autobitumatrice	Copë	3	Në pronësi ose me qera
12	Greider	Copë	4	Në pronësi ose me qera
13	Asfalto shtruese	Copë	4	Në pronësi ose me qera
14	Rrul me vibrim gome cylinder mbi 18 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Rrul cilinder – cilinder10-12 ton asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Rrul me goma asfalti mbi 25 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera

*“ Ndertim Rruga Porto Romano Durrës, Loti 3”*

17	Rul gome cilinder 15 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Rrul vibrus deri ne 8 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
19	Autovinç	Copë	4	Në pronësi ose me qera
20	Minifadrom	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Depozitë Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Motobetoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23	Pompe uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
24	Gjenerator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
25	Makineri vijezi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Vibrator	Copë	6	Në pronësi ose me qera
27	Paisje për hekurthyes (tranxhe / elektrobango)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Instrument Topogjeodezik	Copë	3	Në pronësi ose me qera
29	Nyje inerte e paisur leje mjedisore kodë III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
30	Fabrike asafalti e paisur leje mjedisore kodë III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
31	Fabrike prodhim betoni e paisur leje mjedisore kodë III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
32	Tërheqës + gjysmë rimorkio	Copë	4	Në pronësi ose me qera

- Ne rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve ose cdo formë tjetër kontrate ekuivalente me të të njohura nga legjislacioni shqiptar . Kontratat apo marrëveshjet e sipërcituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe fotot perkatese; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm,

duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për fabriken e asfaltit dhe betonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese. Operatori ekonomik për fabriken e asfaltit dhe betonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së komntrates.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”

*Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".*

2.3.12 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

*Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".*

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese çertifikatat te vlefshme si me poshte:

- EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)
- EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise)
- EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
- ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimit te sigurisë rrugore dhe trafikut )

**\* Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

*Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.*

2.3.14. Operoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.15. Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t`i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.16. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, *duhet t`i përmbahen nenit 74, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar.* duhet të dorëzohet marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në perpjestim dhe perputhje me punet e marra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### **Shtojca 13**

*(Shtojcë për t`u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Bashkelidhur

*“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”*

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur

Grafiku i Punimeve: Bashkelidhur

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

Bashkelidhur DST-ve.

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

**“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## **Punët – Procedura e Hapur**

### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

*“ Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3 ”*

- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantiere për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantieri” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të



firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

#### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë

Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e

hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

#### **Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

